



Data: **15.10.2015**

Për: Shoqërinë “Kostruttiva” S.C.P.A.

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”** me objekt: **“Mbrojtje detare e projektit të mbushjes me rërë e plazhit të Vlorës”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Mbrojtje detare e projektit të mbushjes me rërë e plazhit të Vlorës”**

Kohëzgjatja: **3 (tre) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Fondi limit: **29,550,381 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e një) Lekë (pa TVSH)**

Burimi i financimit: **Buxheti i Shtetit**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Date 11.09.2015**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): **Nuk ka patur**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa TVSH:

Nr.	Operatori Ekonomik	Oferta (pa TVSH)
1.	Labi & Blumar Skelë & Ndërtuesi	25,416,300
2.	Kostruttiva S.C.P.A	29,435,994
3.	Çausi/M	Nuka ka paraqitur ofertë

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtem me arsyet përkatëse:**

**“Ndërtuesi” sh.p.k. dhe “Blumar Skelë” sh.p.k. dhe “Labi” sh.p.k.**

Shoqëria “Ndërtuesi” sh.p.k, nuk plotëson kërkesën 2.1 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim pasi mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve ndaj OSHEE për muajin Korrik 2015 (detyrim ky i maturuar ditën e tenderit).

Shoqëria “Blumar Skelë” sh.p.k, nuk plotëson kërkesën 2.1 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim pasi mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve ndaj OSHEE për muajin Korrik 2015 (detyrim ky i maturuar ditën e tenderit).

Shoqëria “Blumar Skelë” sh.p.k, nuk plotëson kërkesën 2.3.4 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim pasi nuk ka paguar detyrimet për taksat vendore në Komunën Markat ku ushtron aktivitet sipas ekstraktit të QKR.

Shoqëria “Blumar Skelë” sh.p.k, nuk plotëson kërkesën 2.4.3 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim lidhur me stafin e nevojshëm, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për disponimin e stafit.

Shoqëria “Blumar Skelë” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën 2.4.5 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim lidhur me liçencat, pasi ka marrë përsipër punimet e zërit 4 (vendosjen e gjeokonteniereve) dhe nuk ka pikën e liçencës N.S. 18.

Shoqëria “Labi” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën 2.1 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim pasi mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve ndaj OSHEE për muajin Korrik 2015 (detyrim ky i maturuar ditën e tenderit).

**“Çausi/M” sh.p.k për arsye se nuk ka paraqitur ofertë.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë “Kostruttiva” S.C.P.A. se oferta e paraqitur, me vlerë 29,435,994 (**njëzet e nëntë milion e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër**) Lekë (pa TVSH) është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: +355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: +355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **30.09.2015**.

Ankesa: **Nuk ka patur**

